

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 107/2016, “PËR
PREFEKTIN E QARKUT”, TË NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKT AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, të ndryshuar, ka si qëllim forcimin e rolit të prefektit të qarkut, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku, përfshirjen e tij aktive në koordinimin e veprimtarisë së organeve qendrore, në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre në nivel vendor. Prefekti i qarkut merr një rol gjithëpërfshirës edhe për bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi problematikën në lidhje me emergjencat civile.

Me ndryshimet e propozuara, forcohet roli i Prefektit të Qarkut edhe në Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike dhe Këshillin Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, përmes bashkërendimit dhe koordinimit me përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes, si dhe institucioneve në nivel qendror.

Projektligji ka si objektiv përmirësimin e bashkëpunimit midis Prefektit të Qarkut, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim rritjen e sigurisë publike në komunitet.

Për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave del e nevojshme bashkërendimi ndërinstitucional në nivel qarku, për forcimin e qeverisjes përmes koordinimit, me qëllim zbatimin e politikave shtetërore në nivel vendor.

**II. VLERËSIMI I PROJEKT AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve për Ministrinë e Punëve të Brendshme, për vitin 2026, katër mujori i dytë.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKT AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Gjatë zbatimit të ligjit aktual “Për Prefektin e Qarkut” , të ndryshuar, janë evidentuar problematika që lidhen me, koordinimin ndërmjet institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore; qartësinë dhe ndarjen e kompetencave ndërinstitucionale; përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe monitorimit në territor. Problematikat e konstatuara adresohen me përmirësime të ligjit aktual “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar.

Efektet e pritshme janë :

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore për çështje të sigurisë dhe administrimit territorial.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar

- Forcimi i rolit të prefektit në koordinimin me Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake.
- Marrja e një roli edhe më gjithëpërfshirës për bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi problematikat lidhur me emergjencat civile.
- Raportim më i strukturuar pranë Këshillit të Ministrave mbi zbatimin e politikave shtetërore, veçanërisht atyre të planifikimit të territorit.
- Rritje e efektivitetit në menaxhimin e emergjencave civile.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është në harmoni me legjislacionin vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT AKTIT

Projektligji i propozuar përbëhet nga 6 nene, me përmbajtje si më poshtë:

Neni 1 i projektligjit, ndryshon shkronjën “b”, të nenit 8, me këtë përmbajtje:

“b) bashkërendimin, në nivel qarku, të veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe degëve territoriale, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre ligjore, për mbështetjen e njërive të vetëqeverisjes vendore, pa cënuar autonominë vendore dhe kompetencat e organeve përkatëse;”.

Ndryshimi qartëson rolin koordinues të prefektit me institucionet qendrore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 2 i projektligjit, ndryshon nenin 12, me këtë përmbajtje:

Në titullin e nenit, pas fjalëve “*organet e Policisë së Shtetit*” shtohen fjalët “*dhe strukturat e Policisë Bashkiake*”.

Në pikën 4, pas fjalëve “*të Policisë së Shtetit*” shtohen fjalët “*dhe të strukturave të Policisë Bashkiake*”.

Shtesat synojnë dhe bashkëpunimin me Policinë Bashkiake në bashkërendim me kryetarin e Bashkisë, mbi çështjet e sigurisë dhe rendit në komunitet,

Neni 3 i projektligjit, ndryshon nenin 12/1 të ligjit, duke shtuar pikën 1/1 dhe 1/2 dhe 2/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Prefekti i qarkut merr pjesë në mbledhjet e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe, kur çmohet e nevojshme, propozon për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë në komunitet, në bashkërendim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet shtetërore përgjegjëse.

1/2. Prefekti i qarkut analizon problematikat e evidentuara në vendimet e marra nga mbledhjet e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe bashkërendon me institucionet përgjegjëse, masat për

ndjekjen e tyre, përpara përcjelljes së informacionit pranë Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet.”

“2/1. Prefekti i qarkut merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet dhe paraqet problematikat e sigurisë në komunitet në nivel qarku, si dhe bashkërendon me institucionet përgjegjëse për ndjekjen e masave përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.”

Me ndërhyrjet në nenin 12/1, prefekti merr rol aktiv jo vetëm duke marrë pjesë në mbledhjet e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, por edhe duke koordinuar e bashkëpunuar me institucionet shtetërore përgjegjëse, për ndjekjen e masave përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, mbi problematikat e evidentuara në nivel qarku.

Neni 4 i projektligjit, shton pikën 4, në nenin 13 të ligjit aktual me këtë përmbajtje:

“4. Prefekti i qarkut bashkërendon me njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me problematikat për mbrojtjen civile dhe koordinohet me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Forcat e Armatosura për adresimin dhe zgjidhjen e tyre.”

Neni 5 i projektligjit, shton nenin 14/1 në ligjin aktual, me përmbajtjen si vijon:

“Neni 14/1

Bashkërendimi ndërinstitucional në nivel qarku

Prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore dhe degëve territoriale që ushtrojnë veprimtari në qark, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre ligjore, për çështje me interes ndërinstitucional në nivel vendor.

Prefekti i qarkut konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre, duke respektuar parimin e autonomisë vendore.

Prefekti i qarkut nxit dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qendrore, degëve territoriale dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, në nivel qarku, për çështje që kërkojnë trajtim të përbashkët.

Kur çështjet e adresuara nuk zgjidhen nga institucionet përgjegjëse, prefekti i qarkut informon ministrin përgjegjës për veprimtarinë e prefektit dhe, nëpërmjet tij, sipas rastit, Kryeministrin, për problematikat e konstatuara dhe masat e propozuara për zgjidhjen e tyre.”

Shtesat sjellin si risi, përgjegjësinë e prefektit të qarkut për të koordinuar dhe ndërlidhur veprimtarinë e organeve qendrore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tyre në nivel vendor. Gjithashtu, prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë e organeve qendrore dhe organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore në raportet me njëra-tjetrën në nivel qarku.

Neni 6 i projektligjit përcakton hyrjen në fuqi, konkretisht 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen me zbatimin e projektligjit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura, prefektët e qarqeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Policia e Shtetit, Policia Bashkiake, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe fillimisht projektligji dhe relacioni shoqërues është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-akte në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrin të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamentin e Administratës Publike.

➤ **Ministria e Drejtësisë** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, është shprehur si vijon:

1. Sa i përket termave “koordinim” dhe “koordinim mbështetës”, është e paqartë se çfarë do të nënkuptohet me këto terma, në kushtet kur as në relacionin shpjegues nuk bëhet një shpjegim referuar këtyre të fundit. Nga ana tjetër, vlerësojmë se duhet të mbahet në konsideratë që përdorimi i tyre, si edhe përmbajtja e projektligjit, duhet të jetë në çdo rast në përputhje me parashikimet e nenit 13 të Kushtetutës, si edhe nenit 2, pika 2, nenit 4 dhe nenit 22, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Ndërkohë, termi “koordinim” në ligjin aktual përdoret vetëm në pikën 3, të nenit 13 sipas së cilës prefekti i qarkut koordinon në nivel qarku veprimet në terren të njësive të Forcave të Armatosura, të cilat angazhohen bazuar në deklaratimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, me qëllim realizimin e detyrave me karakter civil, që u ngarkohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile, në kuptim të drejtimit të tyre. Sa më sipër, sugjerojmë që këto terma të zëvendësohen me termin “bashkërendim” i cili sipas fjalorit të gjuhës shqipe dhe sipas kuptimit që rrjedh nga përmbajtja e dispozitave në fuqi të nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, në vijim, (ligji nr. 107/2016), përshkruan më mirë veprimtarinë dhe marrëdhënien që ndërton prefekti me organet e vetëqeverisjes vendore. *Ky koment është reflektuar plotësisht.*

2. Sa i përket nenit 2 të projektligjit, shprehem si vijon:

2.1 Është e paqartë ndërhyrja sipas pikës 3, përsa kohë bëhet fjalë për të njëjtin institucion dhe çështje.

2.2 Shtimi i pikës 3/1 duhet të rishikohet në përputhje me parashikimet e nenit 13 të Kushtetutës, si edhe nenit 2, pika 2, nenit 4 dhe nenit 22, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar mbi autonominë vendore, si dhe në përputhje me pikën 1 të nenit 5 dhe nenin 8, të ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake” sipas të cilave Policia Bashkiake është strukturë administrative e bashkisë dhe veprimtaria e saj kontrollohet nga Kryetari i bashkisë.

2.3 Parashikim i pikës 5 është i panevojshëm për sa kohë në pikën 4, të nenit 12 në fuqi, parashikohet se prefekti bashkërendon veprimtarinë dhe siguron mbështetjen e ndërsjelltë edhe të degëve territoriale që veprojnë në qark dhe të organeve të vetëqeverisjes vendore, përfshirë edhe Policia Bashkiake.

Ky koment është reflektuar plotësisht, duke u hequr nga përmbajtja e projektligjit parashikimet e pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 2, i cili prek nenin 12, të ligjit aktual “Detyrat në lidhje me organet e Policisë së Shtetit”. Janë parashikuar disa ndryshime në titull duke shtuar fjalët “dhe strukturat e Policisë Bashkiake”, si dhe në pikën 4, pas fjalëve “të Policisë së Shtetit” shtohen fjalët “dhe të strukturave të Policisë Bashkiake. Këto ndryshime janë në harmoni me ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake duke bashkërenduar me kryetarin e Bashkisë, mbi çështjet e sigurisë dhe rendit në komunitet. Në këtë mënyrë forcohet

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar

bashkëpunimi i Prefektit me Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake, për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, si dy struktura që mbajnë peshën kryesore në këtë drejtim.

3. Sa i përket nenit 3 të projektligjit, vlerësojmë si vijon:

3.1 Lidhur me pikën 1/1, e cila propozohet të shtohet pas pikës 1, të nenit 12/1, të ligjit nr. 107/2016, sjellim në vëmendje se ajo duhet të riformulohet pasi është e paqartë sesi shqyrtohen çështjet përmes bashkërendimit dhe koordinimit. Për rrjedhojë, vlerësojmë se ajo duhet të riformulohet në përputhje me nenin 7, të udhëzimit nr. 6, datë 29.4.2022, të ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”. Nga ana tjetër, bazuar në vendimin nr. 678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet” dhe sipas propozimit, prefekti nuk është anëtar i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike. Si pasojë ai mundet vetëm të propozojë zhvillimin e mbledhjes, pra nuk mund të ftojë kryesisht mbledhjet, pasi kjo është një kompetencën e Kryetarit të bashkisë si kryetar i Këshillit.

3.2 Lidhur me pikën 1/2, vlerësojmë se duhet të mbahet në konsideratë komenti nr. 1

3.3 Lidhur me shtimin e pikës 2/1, pas pikës 2, vlerësojmë se ajo duhet të rishikohet në përputhje me pikën 3, të nenit 12/1, të ligjit nr. 107/2016, në kushtet kur përmbajtja e kësaj pike synon pikërisht të zëvendësojë veprimtarinë e mirëpërcaktuar të KVSP. Nga ana tjetër, kompetencat e prefektit të qarkut në zbatim të nenit 12/1, pika 3, janë përcaktuar me vendimin nr. 678, datë 30.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave

Vendorë të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet”, ku në pikën 10 dhe 11, parashikohet se: “10. Vendimet e marra në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike dërgohen pranë prefektit të qarkut, brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e tyre. 11. Prefekti i qarkut, pas çdo vendimi të marrë nga Këshilli Vendor i Sigurisë Publike, informon Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet.”. Për këtë arsye vlerësojmë, se kjo pikë përbën përsëritje e parashikimit të vendimit të Këshillit të Ministrave e për rrjedhojë duhet të shmanget nga përmbajtja e projektligjit. ***Këto komente janë reflektuar plotësisht duke u riformuluar me përmbajtje si vijon:***

“1/1. Prefekti i qarkut merr pjesë në mbledhjet e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe, kur çmohet e nevojshme, propozon për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë në komunitet, në bashkërendim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet shtetërore përgjegjëse.”

1/2. Prefekti i qarkut analizon problematikat e evidentuara në vendimet e marra nga mbledhjet e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe bashkërendon me institucionet përgjegjëse, masat për ndjekjen e tyre, përpara përcjelljes së informacionit pranë Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet.”

“2/1. Prefekti i qarkut merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet dhe paraqet problematikat e sigurisë në komunitet në nivel qarku, si dhe bashkërendon me institucionet përgjegjëse për ndjekjen e masave përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.”

4. Sa i përket shtimit të neneve 22/1 dhe 22/2, në kushtet kur në relacionin shpjegues nuk janë dhënë argumentet përkatëse nëse roli i Prefektit Detar, është ose jo i njëjtë me Prefektin që ushtron veprimtarinë pranë qarkut Durrës dhe Vlorë, vlerësojmë se këto nene lënë hapësirë për konfuzion. Prefekti si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në çdo qark, caktohet sipas parashikimeve të nenit 114 të Kushtetutës. Veprimtaria e tij rregullohet edhe nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në të cilin në asnjë moment nuk përdoret termi “Prefekt detar”. Në këto kushte, përcaktimi këtij funksioni të ri nuk do të ishte në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe të legjislacionit në fuqi. Nga ana tjetër, një gjë e tillë do të sillte

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar

problematika sa i përket kompetencave dhe konflikteve potenciale midis këtyre dy organeve, e për më tepër në kushtet kur në përmbajtjen e projektligjit, por edhe ato në ato të ligjit në fuqi, nuk parashikohet asnjë dispozitë për fillimin, ndarjen dhe kufizimin e kompetencave midis këtyre dy "lloje" Prefektësh. *Ky koment është reflektuar plotësisht duke u hequr nga përmbajtja e projektligjit neni 22/1 "Prefektit Detar".*

5. Sa i përket përgjegjësiave të prefektit detar, të parashikuara në nenin 22/2, sjellim në vëmendje se ato nuk mund të jenë kompetenca të ndryshme, nga ato që gëzojnë prefektët e tjerë, pasi në vetvete, fakti i vetëm që ndryshon është se territori ku ata ushtrojnë veprimtarinë lidhet vetëm me pozicionin dhe karakteristikat gjeografike të tij. Gjithashtu, ky koment të mbahet në kosndieratë edhe sa i përket komentit nr. 5, si edhe komentit nr. 1. *Ky koment është reflektuar plotësisht duke u hequr nga përmbajtja e projektligjit neni 22/2 "Përgjegjësitë kryesore të prefektit detar".*

- **Ministria e Financave** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, është shprehur se parë në këndvështrimin buxhetor shprehemi si më poshtë:

Projektligji, në tërësi, shoqërohet me kosto të shtuara dhe të paplanifikuara për buxhetin e shtetit, të lidhura me detyra dhe përgjegjësi të reja, si dhe me struktura shtesë që parashikohen të krijohen. Në lidhje me parashikimin për ngritjen e administratës së Prefektit Detar me seli në Durrës dhe Vlorë, theksojmë se, referuar dokumentit të PBA-së 2026-2028, nuk rezulton asnjë fond i planifikuar për këtë qëllim. Për rrjedhojë, në relacionin shoqërues është nevojshme të përllogaritet përafërsisht efekti financiar i strukturës së re që parashikohet të ngrihet, të specifikohet struktura ku pakësohet ky numër, si dhe të përcaktohet burimi i tij i financimit.

Gjithashtu, kërkojmë të mbahet parasysh që ky projektligj të jetë në përputhje dhe në harmoni me kompetencat e njësive vendore që përcakton ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në mënyrë që të mos çënohet autonomia vendore e NJVQV-ve.

Ky projektligj nuk parashikon efekte financiare për buxhetin e shtetit, pasi nenet 6 dhe 7, janë hequr nga përmbajtja e tij. Për këtë arsye nuk do të ketë struktura shtesë, detyra dhe përgjegjësi të reja. Gjithashtu projektligji është në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe nuk çënon autonominë vendore.

- **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, është shprehur si vijon:

1. Ndryshimi i propozuar në nenin 14/1, sipas të cilit prefekti i qarkut **koordinon** dhe ndërlidh veprimtarinë e organeve qendrore në nivel vendor, mbivendos kompetencat e ministrive dhe institucioneve të varësisë së tyre duke e bërë ndërhyrjen e prefektit në këtë proces të krijojë paqartësi hierarkike dhe mbivendosje funksionale. *Ky koment është reflektuar duke riformuluar nenin me përmbajtjen si më poshtë:*

"Neni 14/1

Bashkërendimi ndërinstitutional në nivel qarku

1. *Prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore dhe degëve territoriale që ushtrojnë veprimtari në qark, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre ligjore, për çështje me interes ndërinstitutional në nivel vendor.*
2. *Prefekti i qarkut konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre, duke respektuar parimin e autonomisë vendore.*

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar

3. *Prefekti i qarkut nxit dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qendrore, degëve territoriale dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, në nivel qarku, për çështje që kërkojnë trajtim të përbashkët.*
4. *Kur çështjet e adresuara nuk zgjidhen nga institucionet përgjegjëse, prefekti i qarkut informon ministrin përgjegjës për veprimtarinë e prefektit dhe, nëpërmjet tij, sipas rastit, Kryeministrin, për problematikat e konstatuara dhe masat e propozuara për zgjidhjen e tyre."*

2. Në nenin 22/1, ku parashikohet krijimi i autoritetit të "Prefektit Detar", vlerësojmë se nuk shoqërohet me një përcaktim të qartë të statusit, funksioneve dhe marrëdhënieve institucionale të këtij organi me strukturat ekzistuese. Përdorimi i termit "Prefekturë Detare", krijon paqartësi mbi faktin nëse kemi të bëjmë me një riorganizim të prefekturave ekzistuese apo me krijimin e një strukture të re institucionale, në kundërshtim me kuadrin aktual ligjor, përfshirë ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë".

3. Projektligji, përmes parashikimeve të nenit 22/2 "Përgjegjësitë kryesore të prefektit detar", cenon dhe mbivendos kompetenca të përcaktuara shprehimisht me ligje të posaçme për organe të tjera qendrore. Konkretisht, kompetenca që lidhen me administrimin, sigurinë, kontrollin dhe menaxhimin e veprimtarive detare janë të rregulluara nga ligje si:

- a) ligji nr. 9213, datë 01.04.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën SOLAS";
- b) ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë";
- c) ligji nr. 168/2013 "Për sigurinë në anije dhe në porte";
- ç) ligji nr. 10 109, datë 02.04.2009 "Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë".

Në këtë kuadër, përfshirja e prefektit detar në ushtrimin e këtyre funksioneve krijon paqartësi dhe rrezikon të cenojë parimin e ndarjes së kompetencave ndërmjet autoriteteve përgjegjëse.

4. Në lidhje me nenin 22/2, kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore për administrimin dhe menaxhimin e brezit bregdetar, plazheve, zonave lagunore dhe baseneve ujore janë të përcaktuara qartë në legjislacionin në fuqi, nuk reflekton qartësisht ndarjen e kompetencave ndërmjet prefektit, prefektit detar dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, veçanërisht në administrimin e hapësirave bregdetare dhe aktiviteteve turistike

5. Për sa më sipër, projektligji duhet të rishikohet në mënyrë të thelluar, duke u mbështetur në një vlerësim të detajuar të pasojave që mund të sjellë krijimi i strukturave të reja dhe zgjerimi i kompetencave ekzistuese, të cilat duhet të synojnë garantimin e harmonisë me bazën ligjore në fuqi, veçanërisht në sektorin e transportit detar dhe atë të zhvillimit të territorit, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, efikasitetit administrativ dhe sigurisë juridike, si dhe të shmangien mbivendosjet e kompetencave dhe institucionale, me qëllim garantimin e një zbatimi efektiv dhe të qëndrueshëm të legjislacionit. *Në lidhje me komentet 2, 3 4 dhe 5 janë reflektuar plotësisht duke u hequr nga përmbajtja e projektligjit neni 22/1 dhe 22/2.*

➤ **Ministria e Mjedisit** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, është shprehur si vijon:

Në pikat 2 dhe 3 të nenit 2 të projektligjit, i cili ndryshon nenin 12 të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", të ndryshuar, të shtohen edhe "për çështjet e mjedisit". *Ky koment nuk është reflektuar pasi janë hequr nga përmbajtja e projektligjit parashikimet e pikave 2, dhe 3, të nenit 2, i cili prek nenin 12, të ligjit aktual "Detyrat në lidhje me organet e Policisë së Shtetit".*

Në nenin 6 të projektligjit, nëpërmjet të cilit shtohet neni 22/2, që përcakton detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të prefektit detar, sugjerojmë të shtohen parashikime në lidhje me përgjegjësinë për monitorimin mjedisor dhe biodiversitetit të ujërave detare/bregdetare, me qëllim shmangien e ndotjeve dhe emergjencave civile detare, duke respektuar parimet e mbrojtjes së mjedisit, si dhe ruajtjen e konservimin e biodiversitetit detar.

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar

Ky koment nuk është reflektuar pasi janë hequr nga përmbajtja e projektligjit parashikimet neni 22/1 "Prefektit Detar" dhe neni 22/2 "Përgjegjësitë kryesore të prefektit detar".

- **Ministria e Mbrojtjes** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, është shprehur si vijon:

Sa i takon dispozitave që lidhen me prefektin detar, vlerësojmë se është i nevojshëm harmonizimi i legjislacionit që rregullon detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të kërkim shpëtimit në det, si dhe atyre që lidhen me veprimtarinë e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit (QKKS), me qëllim shmangien e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet këtyre strukturave. Lidhur me nenin 22/1, kërkojmë që ai të ndryshojë sipas përcaktimit të mëposhtëm:

"Prefekti Detar

- 1. Prefekti Detar është përfaqësues i Këshillit të Ministrave, përgjegjës për çështjet detare në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat në territorin e tyre kanë të përfshirë bregdet.*
- 2. Funksioni i "Prefektit Detar", si përfaqësues i Këshillit të Ministrave për çështjet detare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore bregdetare ushtrohet nga Komandanti i Distriktit Detar të Veriut dhe Komandanti i Distriktit Detar të Jugut, sipas ndarjes territoriale përkatëse.*
- 3. Qendrat e prefekturës detare janë në Durrës për prefekturën mbi lumin Seman dhe në Vlorë për prefekturën nën lumin Seman."*

Propozimi ynë vjen si rezultat i reflektimit të një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që rregullojnë menaxhimin dhe operacionet në vijën/kufirin bregdetar, përfshirë ndër të tjera, ligjin nr. 9251/2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr. 8875, datë 4.4.2002, "Për Rojën Bregdetare Shqiptare", të ndryshuar, si dhe legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Forcave të Armatosura, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit (QKKS).

Njëherësh, vlerësojmë se ky propozim i shërben sigurimit, reagimit të menjëhershëm dhe veprimeve opeacionale në det dhe përgjatë vijës bregdetare, duke mundësuar zbatimin e ligjshmërisë detare, si dhe koordinimin me agjencitë e tjera zbatuese dhe pushtetin vendor në zonat përkatëse të përgjegjësisë.

Komandantët e distrikteve shërbejnë si autoritet detar në zonat e tyre të përgjegjësisë duke koordinuar punën me autoritetet lokale dhe agjencitë që kanë interesa në det. Ata sigurojnë kapacitete reagimi për ndotjen detare, si në det ashtu dhe përgjatë vijës në bashkërendim me autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit detar.

Pavarësisht se sugjerimi ynë i referohet strukturave ushtarake, theksojmë se Forcat e Armatosura, për shkak të natyrës së funksioneve që ushtrojnë, angazhohen dhe në veprimtari me karakter civil, në mbështetje të interesit publik dhe nevojave operacionale. Pra, ngarkimi i komandantëve të distrikteve me kompetencat e parashikuara për "Prefektin Detar" përbën një zgjidhje funksionale dhe efëcente.

Argumenteve të mësipërme u shtohet edhe efekti financiar, pasi krijimi i një strukture të re "Prefekt Detar" do të kërkonte buxhet shtesë, ndërkohë që komandantët e distrikteve janë aktualisht në detyrë dhe disponojnë kapacitetet, personelin dhe mekanizmat e nevojshëm për ta mbuluar këtë funksion brenda buxhetit të miratuar. Për rrjedhojë, është më e arsyeshme që funksionet e parashikuara të realizohen përmes strukturave ekzistuese, pa krijuar një strukturë të re. *Sugjerimi nuk është reflektuar pasi janë hequr nga përmbajtja e projektligjit parashikimet neni 22/1 "Prefektit Detar" dhe neni 22/2 "Përgjegjësitë kryesore të prefektit detar".*

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, është shprehur si vijon:

Të mbahet në konsideratë që ndryshimet e propozuara, të cilat synojnë t'i japin prefektit autoritet për të koordinuar ose angazhuar strukturat rajonale të institucioneve qendrore, pa miratimin paraprak të ministrit përgjegjës, nuk duhet të krijojnë mbivendosje kompetencash. Prefekti nuk mund të angazhojë apo të koordinojë struktura si DUK, AREB-et etj. përfshirë edhe rastet e situatave të emergjencave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore apo dora e njeriut, pasi këto institucione veprojnë bazuar në një kuadër të caktuar ligjor dhe në buxhetin sektorial të planifikuar për përmbushjen e përgjegjësiave të tyre institucionale. **Ky koment është reflektuar duke riformuluar nenin me përmbajtjen si më poshtë:**

“Neni 14/1

Bashkërendimi ndërinstitutional në nivel qarku

1. Prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore dhe degëve territoriale që ushtrojnë veprimtari në qark, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre ligjore, për çështje me interes ndërinstitutional në nivel vendor.
2. Prefekti i qarkut konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre, duke respektuar parimin e autonomisë vendore.
3. Prefekti i qarkut nxit dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qendrore, degëve territoriale dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, në nivel qarku, për çështje që kërkojnë trajtim të përbashkët.
4. Kur çështjet e adresuara nuk zgjidhen nga institucionet përgjegjëse, prefekti i qarkut informon ministrin përgjegjës për veprimtarinë e prefektit dhe, nëpërmjet tij, sipas rastit, Kryeministrin, për problematikat e konstatuara dhe masat e propozuara për zgjidhjen e tyre.”

- **Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, është shprehur parimisht dakord, brenda fushës së përgjegjësisë.
- **Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore** nëpërmjet Vendimit nr. 5, date 23.04.2026 “Për miratimin e projektakteve object konsultimi në mbledhjen e Këshillit Konsultativ, Qeverisje Qendrore-Vetëqeverisje Vendore të dates 23.04.2026”, pika 6, është shprehur si vijon:

Për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të qartësohet çfarë nënkupton roli koordinues i prefektit lidhur me policinë bashkiake, ndërkohë në pr/ligjin për policinë bashkiake parashikohet që prefekti koordinon bashkëpunimin e policisë bashkiake me institucionet qendrore në nivel vendor;

Ky koment është reflektuar plotësisht duke hequr nga përmbajtja e projektligjit parashikimet e pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 2, i cili prek nenin 12, të ligjit aktual “Detyrat në lidhje me organet e Policisë së Shtetit”. Janë parashikuar disa ndryshime në titull duke shtuar fjalët “dhe strukturat e Policisë Bashkiake”, si dhe në pikën 4, pas fjalëve “të Policisë së Shtetit” shtohen fjalët “dhe të strukturave të Policisë Bashkiake. Këto ndryshime janë në harmoni me ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake duke bashkërenduar me kryetarin e Bashkisë, mbi çështjet e sigurisë dhe rendit në komunitet. Në këtë mënyrë forcohet bashkëpunimi i Prefektit me Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake, për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, si dy struktura që mbajnë peshën kryesore në këtë drejtim.

Në Nenin 14/1. "Koordinimi me organet qendrore" propozojmë të hiqet pika 2 "Prefekti i qarkut konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për çështjet dhe problematikat në nivel vendor", pasi koordinimi me njësitë vendore është trajtuar në nenet 15 e në vazhdim të ligjit aktual. **Ky koment është reflektuar duke riformuluar nenin me përmbajtjen si më poshtë:**

"Neni 14/1

Bashkërendimi ndërinstitutional në nivel qarku

1. *Prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore dhe degëve territoriale që ushtrojnë veprimtari në qark, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre ligjore, për çështje me interes ndërinstitutional në nivel vendor.*
2. *Prefekti i qarkut konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre, duke respektuar parimin e autonomisë vendore.*
3. *Prefekti i qarkut nxit dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qendrore, degëve territoriale dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, në nivel qarku, për çështje që kërkojnë trajtim të përbashkët.*
4. *Kur çështjet e adresuara nuk zgjidhen nga institucionet përgjegjëse, prefekti i qarkut informon ministrin përgjegjës për veprimtarinë e prefektit dhe, nëpërmjet tij, sipas rastit, Kryeministrin, për problematikat e konstatuara dhe masat e propozuara për zgjidhjen e tyre."*

➤ **Departamenti i Administratës Publike** nuk ka kthyer përgjigje nëpërmjet sistemit E-Akte.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI

BESFORT LAMALLARI

